



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.40

19 mars

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9880 datë 25.2.2008	Për nënshkrimin elektronik	1781
Ligj nr.9881 datë 28.2.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për tregtinë me avionët civilë”	1794
Ligj nr.9882 datë 28.2.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar	1800
Ligj nr.9883 datë 28.2.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) dhe KFW, Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë”	1806
Ligj nr.9884 datë 28.2.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar”	1813
Vendim i Kuvendit nr.168, datë 10.3.2008	Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1815
Vendim i Kuvendit nr.169, datë 10.3.2008	Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1815
Vendim i Kuvendit nr.170, datë 10.3.2008	Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1816
Vendim i Kuvendit nr.171, datë 10.3.2008	Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1816

Vendim i Kuvendit nr.172, datë 10.3.2008	Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1817
Vendim i Kuvendit nr.173, datë 10.3.2008	Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1817

LIGJ
Nr.9880, datë 25.2.2008

PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e nënshkrimeve elektronike në Republikën Shqipërisë.

Neni 2

Përdorimi i nënshkrimit elektronik

1. Përdorimi i nënshkrimit elektronik është vullnetar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj.

2. Dispozita të tjera ligjore mund të kërkojnë përmbushjen e kushteve shtesë për përdorimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara për veprimtarinë administrative të organeve publike.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Nënshkrim elektronik” janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar.

2. “Nënshkrimet elektronike të avancuara” janë nënshkrimet elektronike, të cilat:

- a) i jepen ekskluzivisht një zotëruesi specifik të kodit të nënshkrimit;
- b) mundësojnë identifikimin e zotëruesit të kodit të nënshkrimit;
- c) prodhohen me mjete të sigurta, që mund të mbahen nën kontrollin vetëm nga zotëruesi i kodit të nënshkrimit;
- ç) lidhen me të dhënat, në mënyrë të tillë që të mundësojnë dallimin lehtësisht të çdo ndryshimi të mëpasshëm të këtyre të dhënave.

3. “Nënshkrimet elektronike të kualifikuara” janë nënshkrimet elektronike të avancuara, të cilat:

a) mbështeten në një certifikatë të kualifikuar, që është e vlefshme në çastin e krijimit të nënshkrimit;

b) janë prodhuar me një mjet të sigurt për krijimin e nënshkrimeve.

4. “Kode të nënshkrimeve” janë të dhënat elektronike unike, të tilla si kode ose algoritme kriptografie private, të cilat përdoren për të krijuar një nënshkrim elektronik.

5. “Kode kontrolluese të nënshkrimeve” janë të dhënat elektronike, të tilla si kode ose algoritme kriptografie publike, të cilat përdoren për të kontrolluar dhe verifikuar një nënshkrim

elektronik.

6. “Certifikatat” janë vërtetime elektronike, të cilat lidhin kodet kontrolluese të nënshkrimeve me një person dhe konfirmojnë identitetin e tij.

7. “Certifikatat e kualifikuara” janë certifikatat e lëshuara nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit, në përputhje me këtë ligj, që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

8. “Ofruesit e shërbimeve të certifikimit” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara ose vula kohore të kualifikuara.

9. “Zotëruesit e kodeve të nënshkrimeve” janë personat fizikë, të cilët zotërojnë kode nënshkrimesh. Në rastin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, atyre u caktohen kodet verifikuese përkatëse të nënshkrimeve në certifikatat e kualifikuara.

10. “Mjete të sigurta të krijimit të nënshkrimeve” janë produkte *hardware* dhe *software*, të krijuara posaçërisht për nënshkrimet elektronike të kualifikuara, që përdoren për të ruajtur dhe aplikuar kodet përkatëse të nënshkrimeve, sipas kërkesave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

11. “Përbërësit e aplikimit të nënshkrimeve” janë produkte *hardware* dhe *software* të projektuara për:

a) lidhjen e të dhënave me procesin e krijimit ose verifikimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara;

b) verifikimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ose kontrollimin e certifikatave të kualifikuara dhe paraqitjen e rezultateve.

12. “Përbërësit teknikë për shërbimet e certifikimit” janë produkte *hardware* dhe *software* të projektuara për:

a) krijimin e kodeve të nënshkrimeve dhe transferimin e tyre në një mjet të sigurt të krijimit të nënshkrimeve;

b) mbajtjen e certifikatave të kualifikuara në dispozicion për verifikimin dhe, nëse është e nevojshme, për t’u shkarkuar nga publiku përmes mjeteve elektronike;

c) krijimin e vulave kohore të kualifikuara.

13. “Produktet për nënshkrimet elektronike të kualifikuara” janë mjete të sigurta për krijimin e nënshkrimeve, përbërësve të aplikimit të nënshkrimeve dhe përbërësve teknikë për shërbimet e certifikimit.

14. “Vula kohore të kualifikuara” janë certifikata elektronike, të lëshuara nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit, që konfirmojnë se të dhëna të caktuara elektronike janë paraqitur në një kohë të caktuar.

15. “Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik” është organi publik, i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, i përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

16. “Ministri” është ministri përgjegjës i fushës.

KREU II

VLEFSHMËRIA LIGJORE E NËNSHKRIMEVE ELEKTRONIKE DHE PËRJASHTIMET

Neni 4

Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike

Veprimet juridike dhe aktet e hartuara nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, mund të bëhen edhe përmes një dokumenti elektronik, të cilit i bashkëlidhet një nënshkrim elektronik i kualifikuar. Dokumenti elektronik, i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.

Neni 5

Nënshkrimi elektronik i kualifikuar i kontratës

Nëse veprimi juridik është një kontratë, atëherë secila prej palëve duhet të nënshkruajë të

njëtin dokument me nënshkrimet elektronike të kualifikuara përkatëse.

Neni 6 **Heqja dorë**

Palët mund të bien dakord të heqin dorë nga të drejtat që u jep ky kre.

Neni 7 **Përfshirjet**

Nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret në rastet e mëposhtme:

1. Në veprimet juridike në fushat e së drejtës familjare dhe të së drejtës së trashëgimisë, të cilat u nënshtrohen kërkesave të veçanta ligjore.
2. Në veprime të tjera juridike, të cilat kërkojnë legalizim publik, një akt noterial ose një autorizim nga gjykata.
3. Në veprimet ligjore, që lidhen me garancinë pasurore për lirimet me kusht.
4. Kurdoherë kur ligji nuk lejon përdorimin e formës elektronike.

Neni 8 **Vërtetësia e përmbajtjes së dokumentit**

Përmbajtja e një dokumenti të nënshkruar me një nënshkrim elektronik të kualifikuar prezumohet se është e vërtetë dhe se nuk është ndryshuar, për sa kohë që nuk provohet e kundërta.

Neni 9 **Pavlefshmëria e nënshkrimeve elektronike**

Nënshkrimi elektronik vlerësohet i pavlefshëm, kur vërtetohet se nuk janë përmbushur kërkesat për sigurinë, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

KREU III AUTORITETI, REGJISTRIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 10 **Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik**

1. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, në vazhdim Autoriteti, është institucioni që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
2. Autoriteti është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit që mbulon punët e brendshme.
3. Autoriteti e ka selinë në Tiranë.
4. Autoriteti financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhura të krijuara nga veprimtaria e tij.
5. Autoriteti ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta, që burojnë nga ky ligj apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
6. Titullari i Autoritetit emërohet nga ministri, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
7. Nëpunësit e Autoritetit gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Autoritetit, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, u nënshtrohen legjislacionit të punës.
8. Struktura dhe organika miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullorja e funksionimit të Autoritetit miratohet nga ministri.

Neni 11

Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve të certifikimit

Autoriteti regjistron emrat e ofruesve të shërbimeve të certifikimit, si dhe të ofruesve të shërbimeve të certifikimit, të cilët e kanë ndërprerë veprimtarinë, sipas neneve 13 e 46 të këtij ligji. Ky regjistër përditësohet dhe publikohet në formë elektronike.

Neni 12

Mbikëqyrja

Autoriteti mund të lidhë marrëveshje me subjekte publike dhe private për realizimin e veprimtarisë mbikëqyrëse. Në çdo rast, kjo veprimtari duhet të lidhet me detyra të veçanta dhe që nuk mund të kryhen në atë kohë nga Autoriteti.

Neni 13

Ndërprerja e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit

Autoriteti ndërpret përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të certifikimit në rastet kur:

- a) nuk ka besueshmërinë e nevojshme, për të funksionuar, si i tillë;
- b) nuk zotëron njohuritë e specializuara të nevojshme për të funksionuar, sipas nenit 19 të këtij ligji;
- c) nuk zotëron garancitë e nevojshme financiare, sipas nenit 19 të këtij ligji;
- ç) përdor produkte të papërshtatshme për nënshkrimet elektronike;
- d) nuk i përmbush kushtet e tjera për të funksionuar si ofrues i shërbimeve të certifikimit, sipas këtij ligji ose akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 14

Shfuqizimi i certifikatave të kualifikuara nga Autoriteti

1. Autoriteti urdhëron shfuqizimin e certifikatave të kualifikuara në rast se:
 - a) nuk kanë sigurinë e mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave;
 - b) mjetet e krijimit të nënshkrimit elektronik kanë mangësi për sigurinë dhe mundësojnë falsifikimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara apo të të dhënave, që lidhen me këtë nënshkrim, pa u zbuluar.
2. Autoriteti konstaton pavlefshmërinë e certifikatave të kualifikuara, që janë të falsifikuara.
3. Procedura e çregjistrimit dhe informimi i të tretëve rregullohen me akte nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 15

Vlefshmëria e certifikatave të kualifikuara

Vlefshmëria e certifikatave të kualifikuara, të lëshuara nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit, nuk cenohet nga masat e marra ndaj ofruesit të shërbimit, në zbatim të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 16

Inspektimi dhe informimi

1. Autoriteti, në ushtrimin e kompetencave të tij, ka të drejtë të inspektojë apo të kërkojë informacion nga ofruesit e shërbimeve në mënyrë periodike apo kurdoherë që e gjykon të arsyeshme.
2. Autoriteti inspekton apo kërkon informacion kurdoherë kur:
 - a) disponon të dhëna për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) paraqiten ankesa nga kërkuesit apo zotëruesit e nënshkrimeve elektronike.

Neni 17

Bashkëpunimi gjatë inspektimit

1. Ofruesit e shërbimeve të certifikimit dhe personat e tretë, që punojnë për ta, lejojnë në çdo kohë personat, të cilët veprojnë në emër dhe me autorizim të Autoritetit, të hyjnë në mjediset dhe laboratorët e tyre gjatë orarit normal të punës edhe pa paralajmërim.

2. Ofruesit e shërbimeve të certifikimit dhe personat e tretë, që punojnë për ta, janë të detyruar të japin informacion dhe ndihmën e nevojshme, duke u vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin shkresor dhe elektronik.

3. Për ushtrimin e të drejtave, që burojnë nga ky ligj, Autoriteti, kur gjykohet e nevojshme, mbështetet nga autoritetet publike qendrore, vendore dhe ato policore.

KREU IV

OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË CERTIFIKIMIT

Neni 18

Ushtrimi i veprimtarisë së shërbimit të certifikimit

Ofruesi i shërbimit të certifikimit nuk ka nevojë për një autorizim paraprak për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Neni 19

Kushtet për ushtrim veprimtarie

1. Ofrues i shërbimeve të certifikimit mund të jetë çdo person juridik dhe fizik, i cili provon se:

a) zotëron besueshmërinë e nevojshme dhe njohuritë e specializuara, të duhura, për ushtrimin e veprimtarisë si ofrues i shërbimeve të certifikimit;

b) zotëron garancinë e nevojshme financiare për dëmshpërblimet e mundshme, sipas nenit 41 të këtij ligji.

2. Kushtet dhe kriteret, që duhet të zotërojnë ofruesi i shërbimit të certifikimit, përfshirë dhe ato që lidhen me pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 20

Regjistrimi i ushtrimit të veprimtarisë së shërbimit të certifikimit

Personi, që fillon të ushtrojë veprimtarinë e shërbimit të certifikimit, duhet të regjistrohet pranë Autoritetit menjëherë me fillimin e kësaj veprimtarie. Gjatë regjistrimit, ofruesi i shërbimit paraqet dëshmitë e nevojshme, që provojnë përmbushjen e kushteve të parashikuara në nenin 19 të këtij ligji.

Neni 21

Raportimi i rrethanave të pamundësisë së përmbushjes së kushteve

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet të sigurojë që do të përmbushë kushtet e parashikuara në nenin 19 të këtij ligji gjatë gjithë kohëzgjatjes së ushtrimit të veprimtarisë. Çdo rrethanë, që e bën të pamundur një gjë të tillë, duhet t'i raportohet Autoritetit menjëherë.

Neni 22

Transferimi i detyrave të shërbimeve të certifikimit

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit mund t'ua transferojë personave të tretë detyrat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, nëse këta persona

plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 19 të këtij ligji. Transferimi nuk përjashton përgjegjësinë e ofruesit të shërbimit për detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 23

Raportimi periodik

Çdo ofrues i shërbimit të certifikimit duhet të paraqesë një raport vjetor të hollësishëm për veprimtarinë e vet jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. Forma dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen nga Autoriteti.

KREU V

LËSHIMI I CERTIFIKATAVE TË KUALIFIKUARA

Neni 24

Identifikimi i kërkesit të certifikatës së kualifikuar

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit i identifikon me saktësi personat, të cilët bëjnë kërkesë për një certifikatë të kualifikuar dhe, me pëlqimin e kërkesit, ka të drejtë të përdorë të dhënat personale, të mbledhura nga ai, për garantimin e identifikimit të saktë të kërkesit, sipas këtij neni.

2. Ofruesi i shërbimit të certifikimit konfirmon caktimin e një kodi kontrollues të nënshkrimit për një person të identifikuar me një certifikatë të kualifikuar dhe siguron që kjo të mund të verifikohet në mënyrë elektronike nga çdo kërkuar, duke përdorur aksesin publik elektronik.

Neni 25

Të dhëna në certifikatën e kualifikuar, sipas kërkesës së aplikuesit

1. Me kërkesën e aplikuesit, certifikata e kualifikuar mund të përmbajë të dhëna, që lidhen me autorizimin për të vepruar në emër të një pale të tretë, si dhe të dhëna për profesionin apo cilësitë e veçanta të tij.

2. Të dhënat mbi autorizimin për të vepruar në emër të palës së tretë duhet të provohen me dëshmitë përkatëse, ndërsa të dhënat për profesionin dhe të dhënat e tjera për personin duhet të konfirmohen nga organet përgjegjëse për lëshimin e tyre.

3. Me kërkesën e aplikuesit, në një certifikatë të kualifikuar mund të përfshihen edhe të dhëna të tjera personale.

Neni 26

Përdorimi i pseudonimit

1. Me kërkesën e aplikuesit, ofruesi i shërbimeve të certifikimit mund të përdorë në certifikatën e kualifikuar një pseudonim, në vend të emrit të tij.

2. Pseudonimi mund të përdoret edhe për të dhënat në certifikatën e kualifikuar, sipas nenit 25 të këtij ligji, me kusht që pala e tretë apo organi përgjegjës të japë miratimin paraprak.

Neni 27

Ruajtja e të dhënave nga falsifikimi dhe sigurimi i fshehtësisë së kodeve

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit merr masat e nevojshme për të siguruar që të dhënat për certifikatat e kualifikuara të mos falsifikohen pa u vënë re.

2. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit siguron që kodet e nënshkrimeve të mbahen tërësisht të fshehta. Kodet e nënshkrimeve nuk mund të ruhen jashtë pajisjes së sigurt të krijimit të nënshkrimeve dhe aplikuesi nuk mund të ketë akses të drejtpërdrejtë në to.

Neni 28

Besueshmëria e personelit dhe e produkteve

Për qëllimet e certifikimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, ofruesi i shërbimeve të certifikimit punëson personel të besueshëm dhe përdor produkte të besueshme. Aktet nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji, përcaktojnë kriteret e sigurisë për personelin dhe pajisjet.

Neni 29

Siguria e mjetit të krijimit të nënshkrimit

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet të sigurohet që kërkuesi ka marrë në zotërim mjetin përkatës të sigurt për krijimin e nënshkrimit.

Neni 30

Detyrimi për informimin mbi sigurinë

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit informon aplikuesin për masat e nevojshme për rritjen e sigurisë së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara dhe i teston ato në mënyrë të besueshme.

2. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit vë në dijeni aplikuesin, që të dhënat e nënshkrimit elektronik të kualifikuar duhet të nënshkruhen përsëri, nëse niveli i sigurisë së nënshkrimit ekzistues ka rënë me kalimin e kohës.

Neni 31

Detyrimi për informim mbi vlefshmërinë ligjore

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit informon aplikuesin se një nënshkrim elektronik i kualifikuar në veprimet juridike dhe aktet e tjera ka të njëjtën vlefshmëri sikurse edhe nënshkrimi i bërë me dorë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 32

Informimi me shkrim

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit, për të plotësuar detyrimet për informim, sipas neneve 30 dhe 31 të këtij ligji, i jep aplikuesit një informacion me shkrim, për të cilin ky i fundit duhet të konfirmojë me shkrim, si kusht për lëshimin e një certificate të kualifikuar.

Neni 33

Përmbajtja e certifikatave të kualifikuara

Një certifikatë e kualifikuar shoqërohet me një nënshkrim elektronik të kualifikuar dhe duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e zotëruesit të kodit të nënshkrimit dhe, nëse ekziston mundësia e ngatërimit me një emër tjetër, emrit i shtohet një shtojcë, ose zotëruesit të kodit të nënshkrimit i caktohet një pseudonim i pangatërrueshëm dhe që njihet si i tij;

b) kodin e caktuar për testimin e nënshkrimit;

c) caktimin e algoritmeve, me të cilat mund të përdoret kodi i testimit të nënshkrimit, të zotëruesit të kodit të nënshkrimit dhe kodi i testimit të nënshkrimit të ofruesit të shërbimeve të certifikimit;

ç) numrin përkatës të certifikatës;

d) afatin e vlefshmërisë;

dh) emrin e ofruesit të shërbimit të certifikimit dhe shtetin ku është i regjistruar;

e) informacionin, nëse përdorimi i kodit të nënshkrimit është i kufizuar vetëm për disa përdorime, sipas natyrës ose shtrirjes;

ë) informacionin, që certifikata është e kualifikuar;

f) nëse është e nevojshme, cilësitë e veçanta të zotëruesit të kodit të nënshkrimit.

Neni 34
Cilësi të veçanta

1. Cilësitë e veçanta mund të përfshihen edhe në një certifikatë të kualifikuar të veçantë (certifikatë e kualifikuar për attribute të veçanta).

2. Në një certifikatë të kualifikuar për cilësi të veçanta, të dhënat e parashikuara në nenin 33 të këtij ligji mund të zëvendësohen, duke iu referuar qartë të dhënave të certifikatës së kualifikuar, së cilës i referohet, në rast se përdorimi i certifikatës së kualifikuar me cilësi të veçanta nuk është i nevojshëm.

Neni 35
Shfuqizimi i certifikatës së kualifikuar nga ofruesi

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit shfuqizon menjëherë certifikatën e kualifikuar në rast se:

- a) këtë e kërkon zotëruesi i kodit të nënshkrimit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij;
 - b) certifikata është lëshuar në bazë të të dhënave të rreme, që bien në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 33 të këtij ligji;
 - c) ofruesi i shërbimeve të certifikimit ndërpret ushtrimin e veprimtarive dhe kjo veprimtari nuk i transferohet ndonjë ofruesi tjetër të shërbimeve të certifikimit;
 - ç) Autoriteti urdhëron, sipas nenit 14 të këtij ligji.
2. Në kontratën ndërmjet palëve mund të parashikohen shkaqe të tjera për shfuqizimin e certifikatës, pa shmangur shkaqe, që parashikohen në pikën 1 të këtij neni.
3. Akti i shfuqizimit duhet të përcaktojë qartë kohën e hyrjes në fuqi.
4. Shfuqizimi nuk ka efekt prapaveprues.

Neni 36
Revokimi nga ana e zotëruesit

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet të ofrojë pa ndërprerje shërbimin e revokimit të certifikatave, me qëllim që autorizimi për revokimin të ekzekutohet menjëherë, në çdo kohë që kërkohet.

Neni 37
Shfuqizimi i certifikatës, kur pushojnë së ekzistuari kushtet për cilësitë e veçanta

Nëse një certifikatë e kualifikuar përmban të dhënat e parashikuara në nenin 25 të këtij ligji, personat e tretë ose organi përgjegjës për të dhënat apo cilësitë e veçanta për personin mund të kërkojnë shfuqizimin e certifikatës në fjalë, nëse pushojnë së ekzistuari kushtet për këto të dhëna, pas çastit të futjes së tyre në certifikatën e kualifikuar.

Neni 38
Lëshimi i vulave kohore të kualifikuara

Për lëshimin e vulave kohore të kualifikuara nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit duhet të përmbushen të njëjtat kërkesa ligjore, që parashikohen në nenin 28 të këtij ligji.

Neni 39
Dokumentimi i masave të sigurisë dhe i certifikatave të kualifikuara

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit dokumenton të gjitha masat e sigurisë, të marra në zbatim të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe dokumenton certifikatat e kualifikuara, të lëshuara në mënyrë të tillë, që të dhënat dhe saktësia e tyre të jenë të verifikueshme

në çdo kohë.

2. Dokumentimi përpilohet menjëherë dhe në mënyrë të tillë që nuk mund të ndryshohet më vonë pa u vënë re, sidomos në rastet e lëshimit dhe të shfuqizimit të certifikatave të kualifikuara.

Neni 40

E drejta e njohjes me të dhënat e ruajtura nga ofruesi i shërbimeve

Zotëruesit të kodit të nënshkrimit, me kërkesën e tij, i jepet e drejta për t'u njohur me të dhënat dhe hapat proceduralë të lidhur me të, të cilat ruhen nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit.

KREU VI

PËRGJEGJËSIA LIGJORE

Neni 41

Shpërblimi i dëmit

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit dëmshpërblen personat e tretë për çdo dëm të shkaktuar nga të dhënat, që përmban certifikata e kualifikuar ose vula kohore e kualifikuar, apo nga informacioni i dhënë, sipas nenit 24 të këtij ligji, në rastet kur:

a) shkel kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

b) produktet e tij për nënshkrimet elektronike të kualifikuara ose shërbime të tjera të sigurisë teknike nuk funksionojnë siç duhet.

2. Dëmshpërblimi nuk paguhet nëse personat e tretë kanë pasur dijeni apo duhet të dinin për ekzistencën e shkaqeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 42

Përgjegjësi nga detyrimi për shpërblimin e dëmit

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit përgjashtohet nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, nëse provon se ka vepruar pa faj.

Neni 43

Kufizimi në shpërblimin e dëmit

Në rastet kur certifikata e kualifikuar kufizon përdorimin e kodit të nënshkrimit në disa aplikime të caktuara, sipas llojit ose shtrirjes, dëmshpërblimi që paguhet duhet të jetë në përpjesëtim me këtë, brenda këtij kufizimi.

Neni 44

Përgjegjësi në rastet e transferimit

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit mban përgjegjësi edhe në rastet e transferimit të detyrimit për të ofruar shërbime, sipas nenit 22 të këtij ligji.

Neni 45

Garancitë pasurore

Ofruesi i shërbimeve të certifikimit është i detyruar të marrë masat e duhura financiare, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore, për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga:

a) shkelja e ligjit ose e akteve nënligjore në fuqi;

b) mosfunksionimi i duhur i produkteve të nxjerra prej tij, për nënshkrimet elektronike të kualifikuara ose i shërbimeve të tij të sigurisë teknike.

Neni 46

Veprimet pas ndërprerjes së shërbimeve të certifikimit nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit i raporton menjëherë Autoritetit ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë.

2. Në rast të ndërprerjes së veprimtarisë, ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet që menjëherë:

a) të shfuqizojë të gjitha certifikatat e vlefshme;

b) të kujdeset që certifikatat e vlefshme të kalojnë nën kontrollin e një ofruesi tjetër të shërbimeve të certifikimit dhe të mbështesë ofruesin zëvendësues të shërbimeve të certifikimit në mënyrën më të mirë të mundshme, duke i vënë në dispozicion të gjitha të dhënat e nevojshme;

c) të informojë zotëruesit e kodeve të nënshkrimeve për ndërprerjen e veprimtarisë së tij dhe për kalimin e certifikatave në kontrollin e një ofruesi tjetër të shërbimeve të certifikimit.

3. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit duhet të vijoje shërbimet e revokimit edhe në rastin e ndërprerjes së veprimtarisë. Në rast pamundësie të përmbushjes së këtij detyrimi, ai ia raporton këtë fakt Autoritetit, i cili kujdeset më pas për shërbimet përkatëse të revokimit.

KREU VII MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 47

Përdorimi i të dhënave

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit përdor vetëm ato të dhëna personale, të cilat janë të nevojshme për të përmbushur shërbimet e certifikimit dhe vetëm në atë shkallë, që është e nevojshme për qëllimet e lëshimit dhe të mbajtjes së certifikatës.

2. Të dhënat personale merren drejtpërdrejt nga zotëruesi i kodit të nënshkrimit ose nga persona të tretë, me pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 48

Rastet e dorëzimit të të dhënave

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit i dorëzon Autoritetit, me kërkesë të këtij të fundit, të dhënat për identitetin e zotëruesit të kodit të nënshkrimit:

a) kur kjo është e nevojshme për ndjekjen e veprave penale ose të shkeljeve ligjore dhe kur një kërkesë e tillë vjen nga organet e ngarkuara me ligj për hetimin e tyre;

b) për të shmangur rrezikun, që i kanoset sigurisë kombëtare ose rendit publik;

c) për të kryer detyrat, që u ka ngarkuar ligji autoriteteve fiskale, doganore apo organeve të tjera, në hetimin e shkeljeve ligjore;

ç) kur për një gjë të tillë vendos gjykata.

2. Autoriteti, pasi kërkon informacion, vë në dijeni zotëruesin e kodit të nënshkrimit, të cilit i është zbuluar pseudonimi, për sa kohë që kjo nuk kufizon kryerjen e detyrave ligjore ose nëse interesat e zotëruesit të kodit të nënshkrimit për t'u informuar janë më të rëndësishme se arsyet e tjera.

KREU VIII SIGURIA TEKNIKE

Neni 49

Siguria e mjeteve të krijimit të nënshkrimeve

1. Për ruajtjen e kodeve të nënshkrimeve dhe për prodhimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara përdoren mjete të sigurt të krijimit të nënshkrimeve. Këto mjete identifikojnë, me besueshmëri, nënshkrimet e falsifikuara dhe të dhënat e rreme të nënshkruara dhe ofrojnë mbrojtje nga përdorimi i paautorizuar i kodeve të nënshkrimeve.

2. Nëse vetë kodet e nënshkrimeve prodhohen me një mjet të sigurt të krijimit të nënshkrimeve, zbatohen kërkesat e nenit 51 të këtij ligji.

Neni 50

Përbërësit e aplikimit të nënshkrimit

1. Paraqitja e të dhënave, që duhen nënshkruar, kërkon përbërës të aplikimit të nënshkrimit, të cilët tregojnë qartë prodhimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar dhe mundësojnë identifikimin e të dhënave, me të cilat lidhet nënshkrimi.

2. Për të kontrolluar të dhënat e nënshkruara, nevojiten përbërës të aplikimit të nënshkrimit, të cilët tregojnë:

- a) të dhënat, me të cilat lidhet nënshkrimi;
- b) nëse të dhënat janë ndryshuar apo jo;
- c) zotëruesin e kodit të nënshkrimit, të cilit i është caktuar nënshkrimi;
- ç) përmbajtjen e certifikatës së kualifikuar, tek e cila bazohet nënshkrimi dhe certifikatat e duhura të kualifikuara për cilësi të veçanta;
- d) rezultatet e kontrollit të mëvonshëm të certifikatave, sipas parashikimit të bërë në pikën 2 të nenit 24 të këtij ligji.

3. Kur kërkohet nga Autoriteti, përbërësit e aplikimit të nënshkrimit duhet të bëjnë të dukshme, në mënyrë të mjaftueshme, përmbajtjen e të dhënave, që do të nënshkruhen ose që tashmë janë nënshkruar.

4. Zotëruesit e kodit të nënshkrimit duhet t'i përdorin këta përbërës të aplikimit të nënshkrimit ose të bëjnë hapa të tjerë, të përshtatshëm, për të siguruar nënshkrime elektronike të kualifikuara.

Neni 51

Përbërësit teknikë për shërbimet e certifikimit

Përbërësit teknikë për shërbimet e certifikimit përmbajnë kushte që:

1. Sigurojnë se kodet e nënshkrimeve, të prodhuara dhe të transferuara, janë unike, të fshehta dhe përjashtojnë mundësinë e ruajtjes së informacionit jashtë mjetit të sigurt të krijimit të nënshkrimeve.

2. Mbrojnë certifikatat e kualifikuara, të cilat janë në dispozicion për t'u kontrolluar ose shkarkuar, sipas pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji, nga ndryshimet dhe aksesit i paautorizuar.

3. Përjashtojnë mundësinë e falsifikimit në prodhimin e vulave kohore.

Neni 52

Organizmi i testimit dhe konfirmimit

1. Një person fizik ose juridik, me kërkesën e tij, njihet si organizëm testimi dhe konfirmimi nga Autoriteti, nëse vërteton se ka besueshmërinë, pavarësinë dhe njohuritë e specializuara të nevojshme për të ushtruar këto funksione.

2. Njohja si organizëm testimi dhe konfirmimi mund të jetë:

- a) e kufizuar në përmbajtje;
- b) për një periudhë të kufizuar kohore;
- c) e shoqëruar me kushte.

3. Organizmi i testimit kryen detyrat e tij me paanshmëri, në mënyrë të pavarur dhe me profesionalizëm.

4. Organizmi i testimit dokumenton testimet e konfirmimet, të cilat, kur e ndërpret ushtrimin e veprimtarisë, ia dorëzon Autoritetit.

5. Aktet nënligjore përcaktojnë kushtet, kriteret dhe detyrimet, që kanë organizmat e testimit në ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 53

Plotësimi i kërkesave ligjore

1. Konfirmimi për përmbushjen e kërkesave ligjore të neneve 49, 50 e 51 të këtij ligji, si dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, jepet nga organizmi testues.
2. Prodhuesi i produktit për nënshkrimet elektronike, jo më vonë se çasti i nxjerrjes së produktit në treg, depoziton, me shkrim, një kopje të deklaratës së tij pranë autoritetit përkatës, ku vërtetohet se ka përmbushur kërkesat e këtij ligji.
3. Deklaratat e prodhuesve, që përmbushin kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për nënshkrimet elektronike, vihen në dispozicion të çdo të interesuari.

Neni 54

Pranimi dhe përdorimi i nënshkrimeve elektronike dhe i produkteve të huaja

1. Nënshkrimet elektronike dhe produktet e huaja për nënshkrimet elektronike njihen dhe zbatohen në përputhje me aktmarrëveshjet e lidhura nga Republika e Shqipërisë me shtetet e huaja, për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave.
2. Procedurat për vendosjen e nivelit të sigurisë së nënshkrimeve elektronike të huaja dhe të produkteve të huaja për nënshkrimet elektronike përcaktohen me akte nënligjore.

KREU IX KOSTOT DHE TARIFAT

Neni 55

Pagesat

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton masën dhe llojet e tarifave, që duhet t'i paguajnë Autoritetit ofruesit e shërbimeve të certifikimit apo subjektet e tjera, që kanë detyrim, sipas këtij ligji. Vlerat e tarifës nuk mund të jenë më të mëdha se kostot e shërbimit të kryer nga Autoriteti.

KREU X MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 56

Kundërvajtjet

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë 2 milionë lekë shkeljet e mëposhtme:
 - a) kur nuk raportojnë për fillimin e veprimtarisë, sipas nenit 20 të këtij ligji;
 - b) kur nuk kryhet identifikimi i saktë i kërkuarit, sipas pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji;
 - c) kur nuk zbatohen kërkesat e pikës 2 të nenit 25 për marrjen e dëshmive, që provojnë autorizimin për të vepruar në emër të palës së tretë;
 - ç) kur nuk merret miratimi paraprak i palës së tretë, sipas pikës 2 të nenit 26 të këtij ligji;
 - d) kur nuk ndërmerret veprimet e kërkuara pas ndërprerjes së shërbimit të certifikimit, sipas nenit 46 të këtij ligji.
2. Me gjobë 1 milion lekë për shkeljet e mëposhtme:
 - a) kur ofrohet shërbimi i certifikimit në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji;
 - b) kur nuk merren masat e sigurisë, të përcaktuara në nenin 27 të këtij ligji;

- c) kur nuk hartohet dokumentacioni, sipas nenit 39 të këtij ligji;
ç) kur nuk bashkëpunohet me Autoritetin, në zbatim të neneve 17 e 48 të këtij ligji.

Neni 57
Masa të tjera

Pavarësisht nga masat e parashikuara në nenin 56, si dhe rrethanat që përcaktohen në nenin 13 të këtij ligji, kur Autoriteti e gjykon të arsyeshme se shkeljet janë në atë masë apo natyrë sa cenojnë integritetin dhe besueshmërinë e ofruesit të shërbimeve, ndërpret përkohësisht, plotësisht apo pjesërisht veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të certifikimit.

Neni 58
Ankimi dhe ekzekutimi

1. Kundër vendimit të dënimit me gjobë apo masave të ndërprerjes së veprimtarisë bëhet ankim te ministri brenda 10 ditëve nga data e dhënies së tij.
2. Ministri merr vendim brenda 30 ditëve. Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatë.
3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen në përputhje me ligjin “Për kundërvajtjet administrative”. Gjopa është titull ekzekutiv, që vilet nga Autoriteti dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 59
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 19, 28, 52, 54 e 55 të këtij ligji.

Neni 60
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5655, datë 11.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9881, datë 28.2.2008

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN PËR
TREGTINË ME AVIONËT CIVILË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen për tregtinë me avionët civilë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5656, datë 11.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE MBI TREGTINË ME AVIONËT CIVILË

Preambul

Firmëtarët¹ e Marrëveshjes mbi Tregtinë me Avionët Civilë, këtu e quajtur “kjo Marrëveshje”, duke vënë re që ministrat më 12-14 shtator 1973 ranë dakord që tavolina e rrumbullakët e Tokios për bisedimet shumëpalëshe të tregtisë duhet të arrijë zgjerimin dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë botërore, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të pengesave të tregtisë dhe përmirësimit të kuadrit ndërkombëtar për sjelljen e tregtisë ndërkombëtare;

me dëshirën për të arritur lirinë maksimale të tregtisë botërore me avionët civilë, pjesët dhe pajisjet përkatëse, duke përfshirë shmangien e tarifave, dhe në masën më të madhe të mundshme, reduktimin ose eliminimin e efekteve të kufizimit apo deformimit të tregtisë;

me dëshirën për të nxitur zhvillimin e vazhdueshëm teknologjik të industrisë aeronautike mbi një bazë botërore;

me dëshirën për të dhënë mundësi të drejta dhe të barabarta konkurruese për aktivitetet e tyre me avionët civilë dhe për prodhuesit e tyre të marrin pjesë në zgjerimin e tregut botëror të avionëve civilë;

duke ditur rëndësinë e sektorit të avionëve civilë për interesat e tyre të përgjithshëm reciprokë ekonomikë dhe tregtarë;

duke njohur që shumë Firmëtarë e shohin sektorin e avionëve si një përbërës tepër të rëndësishëm të politikave ekonomike dhe industriale;

në përpjekje të eliminimit të efekteve negative mbi tregtinë me avionët civilë që rrjedhin nga mbështetja qeveritare në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e avionëve civilë, ndërsa duke njohur që një mbështetje e tillë qeveritare, si e tillë, nuk do të konsiderohej deformim i tregtisë;

me dëshirën që aktivitetet e tyre të avionëve civilë të zhvillohen mbi një bazë konkurruese sipas pikëpamjes tregtare dhe duke njohur që raportet qeveri-industri ndryshojnë së tepërmi ndërmjet tyre;

duke njohur detyrimet dhe të drejtat e tyre në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë, këtu të quajtur “GATT”, dhe në bazë të marrëveshjeve të tjera shumëpalëshe të negociuara nën kujdesin e GATT-it;

duke njohur nevojën për parashikimin e procedurave ndërkombëtare të njoftimit, konsultimit, mbikëqyrjes dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me qëllim sigurimin e një zbatimi të drejtë, të shpejtë

¹ Termi “Firmëtarë” këtu përdoret me kuptimin e Palëve në këtë Marrëveshje.

dhe të efektshëm të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe ruajtjes së balancimit të të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet tyre;

me dëshirën për të vendosur një kuadër ndërkombëtar që rregullon sjelljen e tregtisë me avionët civilë;

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Mbulimi i produktit

1.1 Kjo Marrëveshje zbatohet për produktet e mëposhtme:

- a) të gjithë avionët civilë,
- b) të gjithë motorët e avionëve civilë dhe pjesët si dhe përbërësit e tyre;
- c) të gjitha pjesët e tjera, përbërësit dhe pjesët dytësore të avionëve civilë;
- d) të gjithë simulatorët e fluturimeve tokësore dhe pjesët dhe përbërësit e tyre, pavarësisht nëse përdoren si pajisje origjinale apo zëvendësuese në prodhimin, riparimin, mirëmbajtjen, rindërtimin, modifikimin ose konvertimin e avionëve civilë.

1.2 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje “avionë civilë” do të thotë: a) të gjithë avionët e ndryshëm nga avionët ushtarakë dhe b) të gjitha produktet e tjera të parashikuara në nenin 1.1 të mësipërm.

Neni 2

Taksat doganore dhe tarifa të tjera

2.1 Firmëtarët bien dakord:

2.1.1 Të eliminojnë më 1 janar 1980 ose në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha taksat doganore dhe tarifën e tjera² të çdo lloji që caktohen për, ose në lidhje me importimin e produkteve, të klasifikuara për qëllime doganore në bazë të titullimeve të tyre përkatëse për tarifën e renditura në aneks, nëse këto produkte janë për përdorim në një avion civil dhe montimin në të, në kuadrin e prodhimit, riparimit, mirëmbajtjes, rindërtimit, modifikimit ose konvertimit;

2.1.2 Të eliminojnë më 1 janar 1980 ose në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të gjitha taksat doganore dhe tarifën e tjera të çdo lloji që vihen për riparimet në avionët civilë;

2.1.3 Të përfshijnë në agjendën e tyre përkatëse GATT, në 1 janar 1980 ose në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, trajtimin pa taksa ose të liruara nga taksat për të gjitha produktet e mbuluara nga neni 2.1.1 i mësipërm dhe për të gjitha riparimet e mbuluara nga neni 2.1.2 i mësipërm.

2.2 Çdo Firmëtar: a) miraton ose përshtat një sistem përdorimi fundor të administratës së doganave për t'u dhënë efekt detyrimeve të tij në bazë të nenit 2.1 të mësipërm; b) siguron që sistemi i tij i përdorimit fundor siguron trajtim pa taksa ose të lirë nga taksat që është i krahasueshëm me trajtimin e dhënë nga Firmëtarët e tjerë dhe që nuk është pengesë për tregtinë; dhe c) informon Firmëtarët e tjerë për procedurat e tij të administrimit të sistemit të përdorimit fundor.

Neni 3

Barrierat teknike për tregtinë

3.1 Firmëtarët vënë re që dispozitat e Marrëveshjes mbi barrierat teknike për tregtinë zbatohet për tregtinë me avionët civilë. Përveç kësaj, Firmëtarët bien dakord që kërkesat e certifikimit për avionët civilë dhe specifikimet për procedurat e operimit dhe mirëmbajtjes rregullohen, ndërmjet Firmëtarëve, nga dispozitat e Marrëveshjes për Barrierat Teknike për Tregtinë.

Neni 4

Prokurimi i drejtuar nga qeveria, nënkontratat e detyrueshme dhe detyrimet

4.1 Blerësit e avionëve civilë duhet të jenë të lirë të zgjedhin furnitorët mbi bazën e faktorëve tregtarë dhe teknologjikë.

4.2 Firmëtarët nuk u kërkojnë shoqërive ajrore, prodhuesve të avionëve ose subjekteve të tjera

² “Tarifa të tjera” ka kuptimin e nenit II të GATT-it.

të përfshira në blerjen e avionëve civilë dhe as nuk ushtrojnë presion të paarsyeshëm mbi ta, për të prokuruar avionët civilë nga një burim i caktuar, që do të përbënte diskriminim ndaj furnitorëve të tjerë nga një Firmëtar.

4.3 Firmëtarët bien dakord që blerja e produkteve të mbuluara nga kjo Marrëveshje duhet të bëhet vetëm mbi bazën e një çmimi, cilësie dhe dorëzimi konkurrues. Në lidhje me aprovimin ose lidhjen e kontratave të prokurimit për produktet e mbuluara nga kjo Marrëveshje, një Firmëtar mund të kërkojë që firmave të tij të kualifikuara t'u jepet e drejta për mundësitë e biznesit mbi një bazë konkurruese dhe sipas kushteve jo më pak të favorshme se ato që u ofrohen firmave të kualifikuara të Firmëtarëve të tjerë³.

4.4 Firmëtarët bien dakord të mënjanojnë vendosjen e detyrimeve të çdo lloji për shitjen ose blerjen e avionëve civilë nga çdo burim i veçantë që do të përbënte diskriminim ndaj furnitorëve nga një Firmëtar.

Neni 5

Kufizimet tregtare

5.1 Firmëtarët nuk zbatojnë kufizime sasiore (kuota importi) ose kërkesa licencimi për importin për të kufizuar importet e avionëve civilë në një mënyrë jo në përputhje me dispozitat e zbatueshme të GATT-it. Kjo nuk përjashton sistemet e monitorimit ose licencimin për importet në pajtim me GATT-in.

5.2 Firmëtarët nuk zbatojnë kufizime sasiore për kërkesat e licencimit për importet dhe të tjera të ngjashme për të kufizuar, për arsye tregtare ose konkurruese, eksportet e avionëve civilë të Firmëtarë të tjerë në një mënyrë jo në përputhje me dispozitat e zbatueshme të GATT-it.

Neni 6

Mbështetja qeveritare, kreditet e eksportit dhe marketimi i avionëve

6.1 Firmëtarët vënë re që dispozitat e Marrëveshjes mbi interpretimin dhe zbatimin e neneve VI, XVI dhe XXIII të Marrëveshjes së përgjithshme mbi tarifën dhe tregtinë (Marrëveshjes mbi subvencionet dhe masat kompensuese) zbatohen për tregtinë me avionët civilë. Ata afirmojnë që gjatë pjesëmarrjes së tyre në, ose në mbështetje të programeve për avionët civilë, ata përpiqen të mënjanojnë efektet negative mbi tregtinë me avionët civilë në kuptimin e neneve 8.3 dhe 8.4 të Marrëveshjes mbi subvencionet dhe masat kompensuese. Ata marrin gjithashtu parasysh faktorët e veçantë që zbatohen në sektorin e avionëve, veçanërisht mbështetjen e përhapur qeveritare në këtë fushë, interesat e tyre ekonomike ndërkombëtare dhe dëshirën e prodhuesve të të gjithë Firmëtarëve për të marrë pjesë në zgjerimin e tregut botëror të avionëve civilë.

6.2 Firmëtarët bien dakord që caktimi i çmimit për avionët civilë duhet të bazohet në një vlerësim të arsyeshëm të kompensimit të të gjitha shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet jorregjueshëm të programeve, shpenzimet e identifikueshme dhe proporcionale të kërtimeve ushtarake dhe zhvillimin e avionëve, përbërësve dhe sistemeve që më vonë zbatohen për prodhimin e këtyre avionëve civilë, shpenzimet mesatare të prodhimit dhe shpenzimet financiare.

Neni 7

Qeveritë rajonale dhe lokale

7.1 Përveç detyrimeve të tyre të tjera në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Firmëtarët bien dakord të mos kërkojnë apo inkurajojnë, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, qeveritë dhe autoritetet rajonale dhe lokale, organet joqeveritare dhe organet e tjera të veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

³ Përdorimi i shprehjes “e drejta për mundësitë e biznesit. ... me kushte jo më pak të favorshme ...” nuk do të thotë që shumica e kontratave të dhëna firmave të kualifikuara të një Firmëtari u jep të drejtën firmave të kualifikuara të Firmëtarëve të tjerë për kontrata me shumica të ngjashme.

Mbikëqyrja, rishikimi, konsultimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

8.1 Ngrihet një komitet mbi tregtinë me avionët civilë (këtu quhet “Komiteti”), që përbëhet nga përfaqësues nga të gjithë Firmëtarët. Komiteti zgjedh kryetarin e tij. Ai mbledhet kur është e nevojshme, por jo më pak se një herë në vit, me qëllim që t’u japë Firmëtarëve mundësinë të konsultohen për çdo çështje në lidhje me operimin e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë zhvillimet në industrinë e avionëve civilë, për të përcaktuar nëse kërkohen amendime për të siguruar vazhdimësinë e tregtisë së lirë dhe të padeformuar, të shqyrtojnë çdo çështje për të cilën nuk ka qenë e mundur të gjendet një zgjidhje e pëlqyeshme nëpërmjet konsultimeve dypalëshe dhe të ushtrojnë ato përgjegjësi që u janë caktuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose nga Firmëtarët.

8.2 Komiteti rishikon çdo vit zbatimin dhe operimin e kësaj Marrëveshjeje duke marrë parasysh objektivat e saj. Komiteti informon çdo vit Palët Kontraktuese të GATT-it në lidhje me zhvillimet gjatë periudhës së mbuluar nga ky rishikim.

8.3 Jo më vonë se fundi i vitit të tretë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje dhe pas kësaj në mënyrë periodike, Firmëtarët ndërmarrin bisedime të tjera me qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e kësaj Marrëveshjeje mbi bazën e reciprocitetit të përbashkët.

8.4 Komiteti mund të ngrejë organe të tilla vartëse sipas nevojës për të mbajtur nën mbikëqyrje të rregullt zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për të siguruar një balancë të vazhdueshme të avantazheve të përbashkëta. Në mënyrë të veçantë, ai ngre një organ të përshtatshëm vartës, me qëllim sigurimin e një balance të vazhdueshme të avantazheve të përbashkëta, reciprocitetit dhe rezultateve të njëjlojta me qëllim zbatimin e dispozitave të nenit 2 të mësipërm në lidhje me mbulimin e produktit, sistemet e përdorimit fundor, taksat doganore dhe tarifa të tjera.

8.5 Çdo Firmëtar ofron shqyrtim favorizues dhe mundësi të përshtatshme për konsultimin e menjëhershëm në lidhje me përfaqësimet e bëra nga një Firmëtar tjetër në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me operimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.6 Firmëtarët njohin nevojën e konsultimeve me Firmëtarët e tjerë në Komitet, me qëllim që të gjenden zgjidhje të pranueshme të përbashkëta para fillimit të një hetimi për të konstatuar ekzistencën, shkallën dhe efektin e çdo subvencionit të pretenduar. Në ato kushte të veçanta në të cilat nuk kryhen konsultime para fillimit të procedurave të brendshme, Firmëtarët njoftojnë menjëherë Komitetin në lidhje me fillimin e këtyre procedurave dhe hyjnë në konsultime të njëkohshme për të kërkuar një zgjidhje bashkërisht të pranueshme, që do të mënjanojë nevojën e masave kompensuese.

8.7 Nëse një Firmëtar mendon se interesat e tij tregtarë në prodhimin, riparimin, mirëmbajtjen, rindërtimin, modifikimin ose konvertimin e avionëve civilë janë cenuar ose mund të cenohen negativisht nga një veprim i një Firmëtari tjetër, ai mund të kërkojë rishikimin e çështjes nga Komiteti. Me një kërkesë të tillë, Komiteti mbledhet brenda tridhjetë ditësh dhe e rishikon çështjen sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim zgjidhjen e çështjeve të përfshira sa më shpejt të jetë e mundur dhe veçanërisht para zgjidhjes përfundimtare të këtyre çështjeve gjetkë. Në këtë kontekst, Komiteti mund të nxjerrë ato vendime ose rekomandime që mund të jenë të përshtatshme. Ky rishikim nuk cenon të drejtat e Firmëtarëve në bazë të GATT-it ose në bazë të instrumenteve të negociuara nga shumë palë në bazë të GATT-it, pasi ato cenojnë tregtinë me avionët civilë. Për qëllimet e ndihmës së shqyrtimit të çështjeve të përfshira, në bazë të GATT-it dhe instrumenteve të tilla, Komiteti mund të japë atë ndihmë teknike që mund të jetë e përshtatshme.

8.8 Firmëtarët bien dakord që në lidhje me çdo mosmarrëveshje në lidhje me një çështje të mbuluar nga kjo Marrëveshje, por që nuk mbulohet nga instrumente të tjera të negociuara nga disa palë në bazë të GATT-it, zbatohen, *mutatis mutandis*, dispozitat e neneve XXII dhe XXIII të Marrëveshjes së përgjithshme dhe dispozitat e mirëkuptimit në lidhje me njoftimin, konsultimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe mbikëqyrjen nga Firmëtarët dhe Komiteti, me qëllim gjetjen e zgjidhjes për këtë mosmarrëveshje. Këto procedura zbatohen gjithashtu për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me një çështje të mbuluar nga kjo Marrëveshje dhe nga një instrument tjetër i negociuar nga shumë palë në bazë të GATT-it, nëse për këtë bien dakord palët në mosmarrëveshje.

Dispozita të fundit

9.1 Pranimi dhe aderimi

9.1.1 Kjo Marrëveshje është e hapur për pranim, nëpërmjet nënshkrimit ose ndryshe, nga qeveritë palë kontraktuese në GATT dhe nga Komuniteti Ekonomik Europian.

9.1.2 Kjo Marrëveshje është e hapur për pranim, nëpërmjet nënshkrimit ose ndryshe, nga qeveritë që kanë aderuar provizorisht në GATT, me kushtet e lidhura me zbatimin e efektshëm të të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, që marrin parasysh të drejtat dhe detyrimet në instrumentet që parashikojnë aderimin e tyre të përkohshëm.

9.1.3 Kjo Marrëveshje është e hapur për aderim nga çdo qeveri tjetër me kushtet në lidhje me zbatimin e efektshëm të të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, që pranohen nga qeveritë dhe Firmëtarët, nëpërmjet depozitimit te Drejtori i Përgjithshëm i Palëve Kontraktuese të GATT-it të një instrumenti aderimi që përcakton kushtet e pranuar.

9.1.4 Në lidhje me pranimin, dispozitat e nenit XXVI:5 (a) dhe (b) të marrëveshjes së përgjithshme do të ishin të zbatueshme.

9.2 Rezervat

9.2.1 Rezervat nuk mund të bëhen për asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje pa pëlqimin e Firmëtarëve të tjerë.

9.3 Hyrja në fuqi

9.3.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi më 1 janar 1980 për qeveritë⁴ që e kanë pranuar ose aderuar në të deri në atë datë.

9.4 Legjislacioni i brendshëm

9.4.1 Çdo qeveri që pranon ose aderon në këtë Marrëveshje siguron, jo më vonë se nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, përputhshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe procedurave administrative me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

9.4.2 Çdo Firmëtar informon Komitetin për çdo ndryshim të ligjeve dhe rregulloreve të tij, që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje dhe në administrimin e këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

9.5 Amendimet

9.5.1 Firmëtarët mund të ndryshojnë këtë Marrëveshje duke pasur parasysh, ndër të tjera, eksperiencën e grumbulluar nga zbatimi i saj. Një amendim i tillë, në momentin që Firmëtarët kanë dhënë pëlqimin në pajtim me procedurat e përcaktuara nga Komiteti, nuk hyn në fuqi për ndonjë Firmëtar derisa të pranohet nga ky Firmëtar.

9.6 Tërheqja

9.6.1 Çdo Firmëtar mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje. Tërheqja hyn në fuqi me skadimin e dymbëdhjetë muajve nga data në të cilën merret njoftimi me shkrim i tërheqjes nga Drejtori i Përgjithshëm i Palëve Kontraktuese në GATT. Çdo Firmëtar me rastin e një njoftimi të tillë mund të kërkojë një mbledhje të menjëhershme të Komitetit.

9.7 Moszbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Firmëtarëve të veçantë

9.7.1 Kjo Marrëveshje nuk zbatohet ndërmjet dy Firmëtarëve nëse një prej Firmëtarëve, në momentin që pranon ose aderon në Konventë, nuk jep pëlqimin e për një zbatim të tillë.

9.8 Aneksi

9.8.1 Aneksi i kësaj Marrëveshjeje formon një pjesë përbërëse të saj.

9.9 Sekretariati

9.9.1 Kjo Marrëveshje dërgohet nga sekretariati i GATT-it.

9.10 Depozitimi

9.10.1 Kjo Marrëveshje depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm i Palëve Kontraktuese të GATT-it, që i jep menjëherë çdo Firmëtar dhe çdo Palë kontraktuese të GATT-it një kopje të vërtetuar të saj dhe të çdo amendimi të saj në pajtim me nenin 9.5 dhe një njoftim të çdo pranimi të saj apo aderimi në të në pajtim me nenin 9.1, ose çdo tërheqje prej saj në pajtim me nenin 9.6.

9.11 Regjistrimi

9.11.1 Kjo Marrëveshje regjistrohet në pajtim me dispozitat e Nenin 102 të Kartës së

⁴ Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “qeveri” mendohet të përfshijë organet kompetente të Komunitetit Ekonomik Europian. Për çdo qeveri tjetër, ajo hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së pranimit ose aderimit në këtë Marrëveshjeje.

Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Gjenevë, më dymbëdhjetë prill, një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku secili tekst është autentik, nëse nuk përcaktohet ndryshe në lidhje me listat e ndryshme në aneks⁵.

ANEKS
ME NDRYSHIMIN E PROTOKOLLIT (1986) QË NDRYSHON ADERIMIN NË
MARRËVESHJEN PËR TREGTINË ME AVIONËT CIVILË

Mbulimi i produktit

1. Mbulimi i produktit përcaktohet në nenin 1 të Marrëveshjes mbi Tregtinë me Avionët Civilë.

2. Firmëtarët bien dakord që produktet e mbuluara nga përshkrimet e renditura më poshtë dhe të klasifikuara si duhet për qëllimet e doganës në bazë të titujve të nomenklaturës së këshillit të bashkëpunimit të doganave për kodet e sistemit të harmonizuar të treguara të trajtohen pa taksa doganore ose pa tarifa, nëse këto produkte janë për përdorim në avionët civilë ose trajnerë të fluturimeve tokësore⁶ dhe për montimin në to, gjatë prodhimit, riparimit, mirëmbajtjes, rindërtimit, modifikimit ose shndërrimit të tyre.

3. Këto produkte nuk përfshijnë:

- një produkt të paplotë ose të papërfunduar, nëse nuk ka karakterin thelbësor të një pjese të plotë ose të përfunduar, përbërës, pjesë dytësore ose një objekt pajisjeje të një avioni civil ose trajneri të fluturimit tokësor (p.sh., një artikull që ka një numër të prodhuesit të avionit);

- materiale të çdo forme (p.sh. pëlhura, pllaka, forma profilesh, petëza, shufra, qyngje, tuba ose forma të tjera) nëse ato nuk janë prerë sipas madhësisë ose formës dhe/ose me formën për t'u montuar në avion civil ose në një trajner të fluturimeve tokësore (p.sh. një artikull që ka një numër pjese të prodhuesit të një avioni civil);

- lëndët e para dhe mallrat e konsumit.

4. Për qëllimet e këtij aneksi, "Ex" është përfshirë për të treguar që përshkrimi i produktit të përmendur nuk shteron të gjithë gamën e produkteve brenda titullimeve (të rishikuara) të nomenklaturës së këshillit të bashkëpunimit të doganave ose kodet e sistemit të harmonizuar të renditur më poshtë⁷.

LIGJ
Nr.9882, datë 28.2.2008

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9048, DATË 7.4.2003
"PËR TRASHËGIMINË KULTURORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

⁵ Më 25 mars 1987, Komiteti vendosi që teksti në spanjisht i Marrëveshjes do të konsiderohet gjithashtu autentik.

⁶ Për qëllimet e nenit 1.1 të kësaj Marrëveshjeje, "simulatorë të fluturimeve tokësore" konsiderohen si trajnerë të fluturimeve tokësore sipas parashikimit të pikës 8805.20 të sistemit të harmonizuar.

⁷ Lista nuk është dhënë.

Neni 1

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 12 shtohen fjalët “Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, drejtoritë rajonale të kulturës kombëtare, Fototeka “Marubi”, Muzeu i Artit Mesjetar Korçë, Galeria Kombëtare e Arteve, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit”.

2. Pikat 5 e 22 shfuqizohen.

3. Pas pikës 34 shtohet pika 35 me këtë përmbajtje:

“35. “Zonë-muze” është njësia territoriale brenda qytetit, me vlera muzeale, e cila përbëhet nga një grup objektesh me vlera të rëndësishme kulturore.”.

Neni 2

Pikat 3 e 4 të nenit 5 shfuqizohen.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ngrihet Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje ka specialistë të fushës. Komiteti mbikëqyr veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, si dhe harton e miraton strategjitë e programet e zhvillimit në këtë fushë. Anëtarët e komitetit shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje. Përbërja e këtij komiteti dhe masa e shpërblimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregullorja dhe mënyra e funksionimit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozimin e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, shpall krijimet më të spikatura të trashëgimisë jomateriale “Kryevepër e trashëgimisë kulturore shpirtërore”.

Neni 4

Në nenin 7, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Institucionet shtetërore, të specializuara sipas kriterëve shkencore, bëjnë përcaktimin e vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore, të shpallura si të tilla, pronë e çdo personi fizik apo juridik, si dhe dokumentimin e tyre.”.

Neni 5

Në nenin 9 pika 4, pas fjalëve “institucionet e specializuara” fjala “shkencore” hiqet.

Neni 6

Në nenin 10, në fund të pikës 1, fjalët “Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore ose Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit” zëvendësohen me fjalët “institucionet shtetërore të specializuara”.

Neni 7

Në nenin 12, pas fjalëve “kombëtare dhe unike” shtohen fjalët “kur pronari refuzon të sigurojë kushtet për ruajtjen e tyre”.

Neni 8

Në nenin 13, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
“Për restaurimin e këtyre objekteve ata janë të detyruar t’u drejtohen institucioneve shtetërore të specializuara.”.

Neni 9

Në nenin 15 pika 1, fjalët “Instituti i Monumenteve të Kulturës, nëpërmjet drejtorive rajonale të monumenteve të kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore ose Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit” zëvendësohen me fjalët “institucionet shtetërore të specializuara”.

Neni 10

Në nenin 18 paragrafi i dytë, pas fjalëve “monumente të kulturës” shtohen fjalët “në pronësi shtetërore”.

Neni 11

Në nenin 24 pika 2, fjalët “qendër arkeologjike” zëvendësohen me fjalët “zonë arkeologjike”.

Neni 12

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Monumente kulturore të kategorisë II janë ndërtimet me vlera të spikatura, kryesisht në pamjen e tyre të jashtme. Ato ruhen në vëllime dhe pamjen e tyre të jashtme. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore i shpall ato monumente kulturore të kategorisë II.”.

Neni 13

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektsh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objektsh është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike shpallen të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

4. Rregullorja e administrimit për kategorinë e objekteve të mësipërme dhe zonën e mbrojtur rreth tyre miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Heqja e plotë ose pjesëshe e shkallës së mbrojtjes në këtë kategori objektsh bëhet me vendim të po atij organi, që e ka vendosur atë.

6. Monumentet e kulturës të kategorisë I dhe II në qendrat historike, qytetet-muze dhe ansamblet-muze mund të shfrytëzohen edhe për funksione të tjera, që nuk cenojnë në asnjë mënyrë vlerat e tyre. Aty mund të vendosen institucione shtetërore ose private, si muze, biblioteka, atelie monumentesh, fototeka, galeri artesh dhe ekspozita të ndryshme.”.

Neni 14

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

1. Zonat dhe parqet arkeologjike shpallen të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të bërë nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në zona “A” dhe zona “B”. Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Rregullorja e administrimit të këtyre zonave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të bërë nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Në zonat arkeologjike “A” është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor.

4. Në zonat arkeologjike “B” lejohen ndërtimet e reja në rastet e përcaktuara në rregulloren e administrimit të këtyre zonave, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.”.

Neni 15

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Institucionet shtetërore, të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, organet e qeverisjes vendore dhe pronarët ose përdoruesit e objektit kanë të drejtën e propozimit për shpalljen e një objekti “Monument kulture”, propozim i cili i drejtohet ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.”.

Neni 16

Në nenin 32, në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në këtë zonë ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor.”.

Neni 17

Në nenin 33 pika 1, fjalët “bëhet vetëm me autorizimin e Institutit të Arkeologjisë ose të Institutit të Monumenteve të Kulturës” zëvendësohen me fjalët “bëhet vetëm me autorizimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, Institutit Arkeologjik, për gërmimet shkencore, si dhe të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, në rastet e gërmimeve të shpëtimit.”.

Neni 18

Në nenin 34 paragrafi i parë, fjalët “me Institutin e Monumenteve të Kulturës, nëpërmjet drejtorive rajonale të monumenteve të kulturës dhe Institutin e Arkeologjisë” zëvendësohen me fjalët “me institucionet shtetërore të specializuara.”.

Neni 19

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit dhe të rigjallërimit të monumenteve të kulturës kryhen me fonde të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të donatorëve të tjerë ose të vetë pronarëve, pasi të jetë miratuar projekti i tyre nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.”.

Neni 20

Në nenin 36 pika 2, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) 60 për qind nga shteti dhe 40 për qind nga pronari, për monumentet e kulturës të kategorisë I.”.

Neni 21

Në nenin 37 pika 2, fjalët “Instituti i Monumenteve të Kulturës” zëvendësohen me fjalët “drejtoria rajonale e kulturës kombëtare”.

Neni 22

Në nenin 39, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Në çdo rast, shfrytëzimi i monumenteve të kulturës bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve për lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet palëve.

3. Kontrata e shfrytëzimit lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe përdoruesit të monumenteve. Në rast se përdoruesi shkel kushtet dhe kriteret e kontratës, atëherë drejtoria rajonale e kulturës kombëtare i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme.”.

Neni 23

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

1. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik është institucion qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, e krijuar për të ushtruar veprimtari në fushën e gërmimeve dhe të studimeve të trashëgimisë kulturore, që preket nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit. Organizimi dhe funksionimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit të përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Statuti i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik miratohet me urdhër të ministrit të përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Struktura dhe organika e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë është organ kolegjal vendimmarrës, që përbëhet nga specialistë të fushave përkatëse, i cili mbledhet periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe kryesohet nga ministri. Përbërja, mënyra e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimi i anëtarëve të këshillit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 24

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Veprimtaritë e përshkruara në nenin 41 realizohen nga institucione shtetërore dhe private të specializuara të fushës përkatëse, vendase ose të huaja. Këto bashkëpunime bëhen në bazë të

marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe. Përfshihet ekskluziviteti i institucioneve të huaja në këto veprimtari. Për bashkëpunim, në çdo rast, merret miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.”.

Neni 25

Në nenin 45, fjalët “Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe drejtoria rajonale e kulturës kombëtare.”.

Neni 26

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, nëpërmjet strukturave të veta dhe në bashkëpunim edhe me persona juridikë dhe fizikë, të licencuar në këtë fushë, bën ndjekjen e gjetjeve rastësore arkeologjike, që dalin gjatë punimeve bujqësore, të ndërtimit, veprave inxhinierike ose konstruksioneve ndërtimore dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave.

Në rastet e zbulimeve të rëndësishme, punonjësi i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të punimeve që dëmtojnë vlerat arkeologjike. Veprimet e mëtejshme vendosen nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë jo më vonë se 10 ditë nga ndërprerja e punimeve.”.

Neni 27

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “këshillohen me specialistë të Institutit të Arkeologjisë dhe të Institutit të Monumenteve të Kulturës” zëvendësohen me fjalët “marrin miratimin, me shkrim, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve dhe të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë”.

2. Fjalja e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe ndryshimet e mundshme të projektit kryhen nga investitori.”.

Neni 28

Në nenin 48, fjalët “Institutin e Arkeologjisë dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës” zëvendësohen me fjalët “Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe drejtorinë rajonale të kulturës kombëtare.”.

Neni 29

Në nenin 50, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të drejtën e vënies së gjobës e kanë inspektorët e institucioneve shtetërore të specializuara, sipas fushave që mbulojnë.”.

Neni 30

Kudo në ligj fjalët “Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore” dhe “ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore”.

Neni 31

Kudo në ligj fjalët “institucionet e specializuara” zëvendësohen me fjalët “institucionet shtetërore të specializuara”.

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 32

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 13,14 dhe 23 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3 e 23 të këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5657, datë 11.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9883, datë 28.2.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM (FSHZH) DHE KFW, FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI RURAL I FURNIZIMIT ME UJË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) dhe KFW, Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë”” me një kredi prej 7 500 000 (shtatë milionë e pesëqind mijë) eurosh dhe një grant prej 1 000 000 (një milion) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5658, datë 11.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE HUAJE, FINANCIMI DHE PROJEKTI NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, TIRANË DHE FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM (FSHZH) (AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROGRAMIT) PËR 7.5 MILIONË EURO (HUA) DHE
1.0 MILIONË EURO (KONTRIBUT FINANCIAR)
Programi rural i furnizimit me ujë

Në bazë të një marrëveshjeje ende për t'u përfunduar ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (Marrëveshje qeveritare), Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Programit dhe KfW në këtë mënyrë hyjnë në marrëveshjen e mëposhtme të huasë, financimit dhe projektit:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë dhe kontributi financiar

1.1 KfW-ja i ofron Huamarrësit një hua jo më shumë se 7.5 milionë euro dhe një kontribut financiar jo më shumë se 1.0 milion euro.

Kontributi financiar nuk është i kthyeshëm përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 5.3.

1.2 Huamarrësi kanalizon huanë dhe kontributin financiar (shumat e pjesshme të të dyjave tani e tutje gjithashtu të përmendura si "Shumat") plotësisht për agjencinë e zbatimit të programit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të programit përdor huanë vetëm për rehabilitimin dhe ndërtimin e sistemeve rurale të furnizimit me ujë dhe, nëse është e zbatueshme, për pajisjet bazë të kanalizimeve dhe kontributin financiar për masa shoqëruese korresponduese (Programi). Agjencia e zbatimit të programit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e programit dhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar me anë të një marrëveshjeje të veçantë, e cila duhet të bihet dakord nga ana e Huamarrësit, të përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Taksat dhe detyrime të tjera publike që i lindin Huamarrësit ose agjencisë së zbatimit të programit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga huaja ose nga kontributi financiar.

Neni 2

**Kanalizimi i huasë dhe kontributit financiar
për agjencinë e zbatimit të programit**

2.1 Huamarrësi kanalizon huanë dhe kontributin financiar për agjencinë e zbatimit të programit si një grant të pakthyeshëm, në bazë të një marrëveshjeje kanalizimi të veçantë.

2.2 Para livrimit të parë nga kredia dhe kontributi financiar, Huamarrësi i dërgon KfW-së një kopje të marrëveshjes së kanalizimit të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huasë dhe kontributit financiar nuk përbën ndonjë detyrim nga ana e agjencisë së zbatimit të programit ndaj KfW-së për detyrime pagesash sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Livrimet

3.1 KfW-ja do të livrojë huanë dhe kontributin financiar në përputhje me ecurinë e programit dhe në bazë të kërkesës së agjencisë së zbatimit të programit. Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, agjencia e zbatimit të programit dhe KfW-ja bien dakord mbi procedurat e livrimit, në veçanti mbi evidencën që provon se shumatat e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.2 KfW-ja rezervon të drejtën të refuzojë livrimet mbas 31 dhjetorit 2014.

Neni 4

Tarifa e detyrimit financiar, interesi dhe shlyerja e huasë

4.1 Huamarrësi paguan një tarifë të detyrimit financiar prej 0.25% p.a. mbi shumat e palivruara të huasë. Kjo tarifë e detyrimit financiar llogaritet për një periudhë që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe përfundon në datën në të cilën janë debituar livrimet.

4.2 Huamarrësi paguan një normë interesi prej 0.75% p.a. për huanë. Interesi kreditohet nga datat në të cilat janë debituar livrimet deri në datat në të cilat janë kredituar shlyerjet në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi paguan tarifën e detyrimit financiar, interesin dhe çdo interes mbi vonesat sipas nenit 4.5 çdo gjashtëmujor, më 30 qershor dhe 30 dhjetor për gjashtëmujorin e dytë që përfundon. Tarifa e parë e detyrimit financiar paguhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Marrësi shlyen huanë si më poshtë:

Këstet	Data			Shuma
1	30 qershor	2018	EUR	125.000,0 0
2	30 dhjetor	2018	EUR	125.000,0 0
3	30 qershor	2019	EUR	125.000,0 0
4	30 dhjetor	2019	EUR	125.000,0 0
5	30 qershor	2020	EUR	125.000,0 0
6	30 dhjetor	2020	EUR	125.000,0 0
7	30 qershor	2021	EUR	125.000,0 0
8	30 dhjetor	2021	EUR	125.000,0 0
9	30 qershor	2022	EUR	125.000,0 0
10	30 dhjetor	2022	EUR	125.000,0 0
11	30 qershor	2023	EUR	125.000,0 0
12	30 dhjetor	2023	EUR	125.000,0 0
13	30 qershor	2024	EUR	125.000,0 0
14	30 dhjetor	2024	EUR	125.000,0 0
15	30 qershor	2025	EUR	125.000,0 0
16	30 dhjetor	2025	EUR	125.000,0 0
17	30 qershor	2026	EUR	125.000,0 0
18	30 dhjetor	2026	EUR	125.000,0 0
19	30 qershor	2027	EUR	125.000,0 0
20	30 dhjetor	2027	EUR	125.000,0 0
21	30 qershor	2028	EUR	125.000,0 0

22	30 dhjetor	2028	EUR	0	125.000,0
23	30 qershor	2029	EUR	0	125.000,0
24	30 dhjetor	2029	EUR	0	125.000,0
25	30 qershor	2030	EUR	0	125.000,0
26	30 dhjetor	2030	EUR	0	125.000,0
27	30 qershor	2031	EUR	0	125.000,0
28	30 dhjetor	2031	EUR	0	125.000,0
29	30 qershor	2032	EUR	0	125.000,0
30	30 dhjetor	2032	EUR	0	125.000,0
31	30 qershor	2033	EUR	0	125.000,0
32	30 dhjetor	2033	EUR	0	125.000,0
33	30 qershor	2034	EUR	0	125.000,0
34	30 dhjetor	2034	EUR	0	125.000,0
35	30 qershor	2035	EUR	0	125.000,0
36	30 dhjetor	2035	EUR	0	125.000,0
37	30 qershor	2036	EUR	0	125.000,0
38	30 dhjetor	2036	EUR	0	125.000,0
39	30 qershor	2037	EUR	0	125.000,0
40	30 dhjetor	2037	EUR	0	125.000,0
41	30 qershor	2038	EUR	0	125.000,0
42	30 dhjetor	2038	EUR	0	125.000,0
43	30 qershor	2039	EUR	0	125.000,0
44	30 dhjetor	2039	EUR	0	125.000,0
45	30 qershor	2040	EUR	0	125.000,0
46	30 dhjetor	2040	EUR	0	125.000,0
47	30 qershor	2041	EUR	0	125.000,0
48	30 dhjetor	2041	EUR	0	125.000,0

49	30 qershor	2042	EUR	0	125.000,0
50	30 dhjetor	2042	EUR	0	125.000,0
51	30 qershor	2043	EUR	0	125.000,0
52	30 dhjetor	2043	EUR	0	125.000,0
53	30 qershor	2044	EUR	0	125.000,0
54	30 dhjetor	2044	EUR	0	125.000,0
55	30 qershor	2045	EUR	0	125.000,0
56	30 dhjetor	2045	EUR	0	125.000,0
57	30 qershor	2046	EUR	0	125.000,0
58	30 dhjetor	2046	EUR	0	125.000,0
59	30 qershor	2047	EUR	0	125.000,0
60	30 dhjetor	2047	EUR	0	125.000,0

4.5 Nëse ndonjë nga këstet e shlyerjes nuk është në dispozicion të KfW-së në kohën e duhur, KfW-ja mund ta rrisë normën e interesit të pagesave të prapambetura në normën bazë plus 3% p.a. për periudhën që fillon nga data e caktuar e pagesës dhe përfundon në datën në të cilën këto shlyerje janë kredituar në llogarinë e KfW-së specifikuar në nenin 4.9. “Norma bazë” është norma e interesit të caktuar nga Deutsche Bundesbank si normë bazë për normën e aplikuar në datën përkatëse të pagimit. Në rastin e interesave të pagesave të prapambetura, KfW-ja mund të kërkojë dëmshpërblim. Këto dëmshpërblime nuk duhet të tejkalojnë shumën që rezulton nëse do të aplikohesh interesin mbi interesin e pagesave të prapambetura sipas normës bazë që ekziston në datën e pagesës plus 3% p.a.

4.6 Tarifa e detyrimit financiar, interesi dhe çdo dëmshpërblim mbi pagesat e prapambetura sipas nenit 4.5 llogaritet në bazë viti me 360 ditë dhe muaji me 30 ditë.

4.7 Shumat e huasë të shlyera para kohe ose të palivruara kreditohen në sasi të barabarta kundrejt të gjitha kësteve të shlyerjeve të papaguara, përveç kur KfW-ja, me lirinë e saj të veprimit, përcakton një metodë të ndryshme shlyerjeje në një rast të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave të sasisë më të vogël.

4.8 KfW-ja rezervon të drejtën të kreditojë, sipas zgjedhjes së saj, pagesat e marra kundrejt pagesave për t’u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huave të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi depoziton të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së nr.31.256.0801 në Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, S.W.I.F.T.: KFWIDEFF), duke mos lejuar të dërgohet asnjë kundërkërkesë kundrejt pagesave të tilla.

Neni 5

Ndërprerja e livrimeve dhe shlyerja e parakohshme

5.1 Huamarrësi në çdo kohë:

a) në varësi të përmbushjes së detyrimeve të tij, sipas nenit 8, mund të anulojë çdo shumë të palivruar ende; dhe

b) mund ta shlyejë huanë plotësisht ose pjesërisht para kohës së maturimit.

5.2 KfW-ja nuk mund t’i ndërpresë livrimet, përveç kur:

a) Huamarrësi nuk arrin t'i përmbushë detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat në kohën e duhur;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj Marrëveshjeje janë shkelur;

c) agjencia e zbatimit të programit është e paafte të provojë që shumat janë përdorur për qëllimin e përcaktuar; ose

d) krijohen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesave të pretenduara nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Në rast se ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a), b) ose c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të caktuar nga ana e KfW-së, e cila, megjithatë, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 a), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të papaguara të huasë, si dhe shlyerjen e të gjithë interesit të akumuluar dhe të gjitha detyrimeve të tjera të rastit;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të pjesëve të livruara të kontributit financiar dhe të të gjitha shumave të papaguara të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit të akumuluar dhe të të gjitha detyrimeve të tjera të rastit;

c) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të tilla kur agjencia e zbatimit të programit është e paafte të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 6

Kostot dhe detyrimet publike

6.1 Huamarrësi shlyen të gjitha pagesat që dalin sipas kësaj marrëveshjeje pa ndonjë zbritje të taksave, detyrime të tjera publike ose kostove të tjera dhe paguan kostot e transferimit dhe shkëmbimit që rrjedhin në lidhje me livrimin e huasë dhe kontributit financiar.

6.2 Huamarrësi përballon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike të akumuluar jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje dhe përfaqësimi

7.1 Në kohën e duhur, para livrimit të parë, Huamarrësi pajis KfW-në me një evidencë të pranueshme për KfW-në, ku vërtetohet se Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjeve të tij kushtetuese dhe ligjeve të tjera për deklarimin e vlefshëm të të gjitha detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

7.2 Ministri i Financave dhe persona të tillë të ngarkuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me anë të firmave specimen të vërtetuara prej tij apo saj, përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe të autorizuar me anë të firmave specimen të vërtetuara prej tij apo saj përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të programit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kompetencat e përfaqësimit nuk përfundojnë deri në kohën kur revokimi i qartë i tyre prej përfaqësuesve të autorizuar në atë kohë të jetë marrë nga ana e KfW-së.

7.3 Amendamente ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim ose deklaratë nga palët kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë merret sapo të arrijë në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në çdo adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në

KfW
Postfach 111141
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax:+996971312944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, nr.4
Tiranë
Republika e Shqipërisë.
Fax: +355-42-28494

Për Agjencinë e Zbatimit: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
të Projektit: Rr: “Sami Frashëri”, nr.10
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Fax: +355-42-34885

7.4 Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore midis KfW-së dhe Huamarrësit, nuk kërkojnë miratimin e agjencisë së zbatimit të projektit.

Neni 8 Programi

8.1 Agjencia e zbatimit të programit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe vazhdon programin në përputhje me praktika të mira teknike dhe financiare dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e programit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të programit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të programit, konsulentëve të kualifikuar dhe të pavarur, dhe zbatimin e programit firmave të kualifikuara;

c) lidh kontratat për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kjo hua dhe kontributi financiar në përputhje me marrëveshjen e veçantë që do të lidhet me KfW-në;

d) mirëmban ose realizon mirëmbajtjen e regjistrave dhe të të dhënave që tregojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo hua dhe kontribut financiar;

e) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të kontrollojnë regjistrat dhe të dhënat, si dhe çdo ose të gjithë dokumentacionin tjetër përkatës që lidhet me zbatimin e programit dhe mundëson që përfaqësuesit e KfW-së të vizitojnë programin dhe të gjitha instalimet lidhur me të;

f) i sigurojnë KfW-së çdo lloj informacioni dhe relacioni të tillë mbi programin dhe ecurinë e tij të mëtejshme siç mund të kërkohej nga KfW-ja; dhe

g) i përcjell KfW-së pa vonesë çdo kërkesë drejtuar Huamarrësit nga ana e OECD-së ose anëtarëve të tyre sipas së ashtuquajturës “Marrëveshje për transparencën e përbashkët të kredive të ODA-s” në vijim të përcaktimit të kontratave për pajisjet e shërbimet që do të financohen nga kredia dhe kontributi financiar dhe koordinon përgjigjen për çdo kërkesë të tillë me KfW-në.

8.2 Agjencia e zbatimit të programit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë lidhur me nenin 8.1 në një marrëveshje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) sigurojnë financimin e plotë të programit dhe, sipas kërkesës, pajis KfW-në me evidencën që provon se kostot e papaguara nga kjo kredi dhe kontribut financiar janë mbuluar; dhe

b) vullnetarisht informojnë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e programit.

8.4 Huamarrësi ndihmon agjencinë e zbatimit të programit në përputhje me praktika të mira teknike dhe financiare në zbatimin e programit dhe në përmbushjen e detyrimeve nga agjencia e zbatimit të programit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, i siguron agjencisë së zbatimit të programit çdo apo të gjitha lejet e domosdoshme për zbatimin e programit.

8.5 Për transportin e mallrave që do të financohet nga kredia zbatohen dispozitat e Marrëveshjes qeveritare të njohura për Huamarrësin.

Dispozita të ndryshme:

9.1 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të programit garantojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, lidhjen e kontratës për pajisje dhe shërbime të financuara, dhe me livrimet e kërkuara të shumave nuk kërkojnë, pretendojnë, kryejnë, sigurojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 KfW-ja rezervon të drejtën t'i sigurojë Republikës Federale të Gjermanisë informacionin lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kësaj huaje, Marrëveshjen e financimit dhe projektit. Si KfW-ja ashtu edhe Republika Federale e Gjermanisë kanë të drejtën për të përcjellë informacionin mbi kredinë, kontributin financiar dhe programin, duke përfshirë lidhjen e kontratave për pajisjet dhe shërbimet e financuara nga kredia dhe kontributi financiar, organizatave ndërkombëtare të angazhuara me mbledhjen e të dhënave statistikore, sidomos lidhur me aspektet e shërbimit të borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave përsa i përket lidhjes së kontratave për pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga kredia dhe kontributi financiar. E drejta e mësipërme për t'ua përcjellë informacionin organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për t'ua kaluar informacionin në fjalë drejtpërdrejt anëtarëve të organizatave të tilla.

9.3 Në rast se ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera nuk influencohen nga kjo. Çdo vakum që do të rezultojë prej kësaj, do të plotësohet nga një dispozitë që është në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.4 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të programit nuk mund të atribuojë ose transferojë, garantojë ose hipotekojë për asnjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.5 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje humbasin fuqinë pesë vjet nga përfundimi i vitit në të cilin ka rrjedhur pretendimi i tillë dhe në të cilin KfW-ja është informuar për rrethanat që përbëjnë pretendimin në fjalë ose mund të ishte e vetëdijshme për to pa ndonjë neglizhencë të madhe.

9.6 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligje të Republikës Federale Gjermane.

Vendi i ekzekutimit është Frankfurt am Main.

9.7 Mosmarrëveshjet do të zgjidhen vetëm dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Lidhur me këtë, do të veprohet si më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre gjyqtarë që do të caktohen dhe veprojnë në përputhje me rregullat e arbitrazhit dhe Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (DNT) të zbatueshme herë pas here.

b) Seancat e arbitrazhit do të kryhen në Frankfurt am Main. Ato do të mbahen në gjuhën angleze.

9.8 Kjo kredi dhe Marrëveshje projekti dhe financimi nuk hyn në fuqi pa hyrë në fuqi Marrëveshja qeveritare në të cilën ajo është bazuar.

Përpiluar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9884, datë 28.2.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5659, datë 11.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË
PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR
(1998, 2001 DHE 2006)**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore ndërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001 dhe të datës 12 shtator 2006 në Tiranë,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditansalt fur Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlefë prej gjithsej 3 556 000 euro (me fjalë: tre milionë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë euro) për projektin “Rezervati ndërkufitar i biosferës në Prespë”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt fur Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si

dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të lidhet midis Kreditansalt fur Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvlefësohet, në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit përkatës të premtimit. Për shumën e pjesshme nga viti i premtimit 1998, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2006, për shumën e pjesshme nga viti i premtimit 2001, afati mbaron në datën 31 dhjetor 2009, për shumë e pjesshme nga viti i premtimit 2006, afati mbaron në datën 31 dhjetor 2014.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditansalt fur Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt fur Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datën 16.1.2008 në dy kopje origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM Nr.168, datë 10.3.2008

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Afrim Tonuzi emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.169, datë 10.3.2008

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Jetmir Karini emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.170, datë 10.3.2008

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Edlira Kasaj emërohet anëtare e Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.171, datë 10.3.2008

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilir Zela emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

**VENDIM
Nr.172, datë 10.3.2008**

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilir Shehu emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

**VENDIM
Nr.173, datë 10.3.2008**

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT

RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilir Shehu zgjidhet Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 17.3.2008
 Doli nga shtypi më 19.3.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë